



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Data/Datum/Date:	18.12.2023
Nr.Br.No:	09/ 125
Për/ Za/To:	Sekretarinë e Kuvendit
Nga/Od/From:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtoresha znj. Albana Fazliu
Lënda/Predmet/Subject:	Procesverbal nga debati publik për Draft-Rregulloren për Procedurat dhe Kriteret për Zgjedhjen e Lauratëve të Vitit në Sport

Debati filloi në ora 14:15

Fatmire Ferati- Kryesuese e grupit punues për hartimin e Draft-Rregullorës për Procedurat dhe Kriteret për Zgjedhjen e Lauratëve të Vitit në Sport: hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit. Ju njoftoj që për hartimin e këtij drafti të kësaj rregullore është themeluar grupi punues nga kryetari i komunës, grupi ka qenë i përbërë nga 6 anëtarë, Fatmire Ferati-Kryesuese e Grupit dhe anëtarët e grupit: Bajram Gashi, Meriton Baftiu, Zenel Shabani, Lulzim Sahiti dhe Idajet Rexhepi.

Si grup kemi punuar në këtë draft-rregullore dhe e kemi përcjellë në kuvend, ku pas mbledhjes së rregullt të kuvendit të mbajtur me datë: 27. 11. 2023 është marrë vendim të del në diskutim publik kjo draft-rregullore. Prandaj sot jemi këtu për të diskutuar për këtë draft-rregullore, për të dhënë kontributin secili prej jush që jeni prezent në këtë debat, unë hap diskutimin, nëse është dikush që dëshiron të marrë fjalën?

Nesret Salihaj: Në radhë të parë dua të di nga kush është themeluar komisioni dhe kush i ka dhënë propozimet për veç Fatmires që dihet që është nga DKRS, të tjerët në cilësinë e kujt janë marrë.

Fatmire Ferati: Siç e ceka dhe më parë komisionin apo grupin punues e ka themeluar kryetari i Komunës.

Nesret Salihaj: Faleminderit për informacionin se nuk e kisha të qartë këtë. Sa i përket kësaj rregullore më vje mirë që po bëhet, por unë sot jam këtu si përfaqësues i klubit të Kik-Boksit dhe dua të mbroj interesat e klubit, dhe mu duk që në këtë draft më shumë ishin të favorizuara sportet kolektive se sa ato individuale. Por unë kam këto propozime:

1. Aneksi 1-Tabela e poentimit, të shtohet si pikë edhe përfaqësimi në garat ndërkombëtare (Kampionati Ballkanik, Kampionati Evropian, Kampionatin Botëror dhe Olimpiadë)

2. Aneksi 2- Tabela e poentimit, të plotësohet pika e fundit: Ekipi me strukturë të kompletuar dhe ekipi më i organizuar me të gjitha kategoritë e grupmoshave.

3. Te Neni 3, pika 3.2 të shpërblimet - të shtohet edhe Shpërblimi i Sportistëve të cilët kanë përfaqësuar Kosovën në arenën ndërkombëtare (Kampionat Evropian, Ballkanik, Kupa Evropiane dhe Kupa Botërore) këta sportist mos të jenë në garë për sportist të vitit.

Fatmire Ferati: Faleminderit Nesret.

Safet Sylja: Përshëndetje për të gjithë, dua të lidhem me pikën që Nesreti e propozoj të shtohet në tabelën e poentimit,

1. Përfaqësimi në garat ndërkombëtare, unë propozoj që të vendosen edhe pikët e poentimit si në vijim: Kampionati Ballkanik **5 pikë**, Kampionati Evropian **15 pikë**, Kampionati Botëror **20 pikë** dhe Olimpiada **10 pikë**.

Adresa: Rr. "Tahir Sinani", nr. 50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës.

Tel.: +383/290-389-016, e-mail: info.shtime@rks-gov.net

<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

2. Propozimi tjetër në Nenin 3, pika 3.2 Shpërblimet do t'u jepen – propozoj të specifikohen si: shpërblimi për sportistin më të sukseshmëm Senior, Junior dhe Kadet.

Edhe një gjë, dua të marr sqarime për pikën 4.1 të Nenit 4 dhe për pikën 10.3 të Nenit 10.

Fatmire Ferati: Faleminderit për propozimet e juaja, dhe do të mundohem të ju jap sqarimin për këto dy pika. Pika 4.1 e nenit 4, tregon qartë që kandidati patjetër duhet të jetë anëtar i klubit që është i licencuar nga federata kombëtare, në Departamentin e Sportit në MKRS dhe të njohur zyrtarisht në Komitetin Olimpik të Kosovës, ndërsa sa i përket pikës 10.3 të nenit 10, një anëtar nga shoqëria civile, ju sqaroj që termi i përgjithshëm për të gjitha OJQ-ët qofshin ato sportive, rinore, kulturore dhe studentore është ky i shoqërisë civile.

Nëse nuk keni diçka më shumë për të shtuar, unë ju falenderoj për sugjerimet, propozimet dhe kontributin e juaj në këtë debat.



Po e shpall të mbyllur këtë takim.

Mbledhja përfundoi në ora 15:40

Procesmajtës: Fatmire Ferati

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË DISKUTIMIN PUBLIK PËR DRAFT-RREGULLORE PËR PROCEDURAT
DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E LAURATËVE TË VITIT NË SPORT**

Shtime, më 18 dhjetor 2023 (e hënë)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	SAFET SYLA	KLUBI KARATE "VJOSA"	
2	NESEFI SAJHAJ	KLUBI KIK-BOKS "SKENOCE BALIHI"	
3	Lulzim Sahiti	Zyra për Informim	
4	Vlora Zyseni	Zyra për informim	
5	Donjeta Gorrolli	Zyra për Informim	
6	Vahide Ejupi	Zyrtar Administrativ	
7	Bejro Gashi	ATLH/SHTIM MANTRI GRUPIT PUNORI	
8	Arben Deliu	DKRS	
9	Fatmire Ferati	DKRS	
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			